

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AS SPORTS MANAGEMENT AGENCY” SH.P.K

Në mbështetje të Neneve 1, 3, 4, 6 e vijues dhe 68 e vijues të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, dhe Nenit 28, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, sot më datë 10.06.2022, Ortaku i Vetëm:

- **Z. Arsel Lampe**, i biri i Alfred dhe Elsa, shtetas shqiptar, lindur më 23.02.1999, në Fier, banues në Rruga “Fortuzi”, Pall.2, Shkalla 3, Ap. 06, Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. 033304581 e Nr. Personal J90223062N, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut zotërues të 100 % (një qind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.

NENI 1
EMËRTIMI I SHOQËRISË

1.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“AS Sports Management Agency” sh.p.k.**, në vijim referuar si **“Shoqëria”**.

NENI 2
BAZA LIGJORE

2.1 *Shoqëria* do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar,



Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar, dhe legjislacionit shqiptar të zbatueshëm.

2.2 Kjo Shoqëri fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 3 SELIA

3.1 Selia kryesore e aktivitetit të Shoqërisë është në adresën: Rruga "Mehmet Brocaj", Godina Nr. 5, Apartamenti Nr. 10, Tiranë.

3.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi dhe atij ndërkombëtar të zbatueshëm.

3.3 Shoqëria mund të hapë shoqëri bija, filiale, degë përfaqësie ose agjenci në varësi të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në çdo kohë që çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente sipas legjislacionit të zbatueshëm.

NENI 4 OBJEKTI

4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë përfshin sa më poshtë vijon:

- **Ndërmjetësim i kontratave të sportistëve, duke përfshirë por pa u kufizuar në kontratat e punësimit me ekipet e futbollit apo me ekipet e sporteve të tjera sipas rastit, kontratat e sponsorizimeve, kontratat e shfaqjeve, intervistave apo paraqitje të tjera televizive, radiofonike dhe/ose media të tjera digjitale, media dhe ose/rrjete sociale, podcast etj., si dhe kontrata të tjera biznesi të sportistëve në varësi të lërkesave specifike.**
- **Këshillim, ndjekje dhe hulumtim tregu për sportistë dhe ekipe të ndryshme për element potencial në treg për kontraktim apo për kontrata të tjera nga ato të përmendura më sipër dhe ose në**

funksion ë studimeve ë ndryshme ë tregut ë lërkua nga klientët klientët përkaës.

- Kërkim dhe mbledhje informacioni për lojtaëpotenciaëkryesisht në sportin e futbollit, por edhe nësporte ëtjera ëndryshme.
- Prezantim i lojtaëve në ekipe ë ndryshme me qëllimin e ndërmjeësimit ë kontraës së punësimit apo ofrimi i shërbimeve ë ndërmjeësimit në rinovimin e Kontraës, prezantimi i dy ekipeve me njëri-tjetrin me qëllimin e ndërmjeësimit dhe arritjes së një marrëveshje transferimi, shitblerje sportisësh etj.
- Shërbime imobiliare, ndërmjeësim në lidhje me transaksione tregtare me objekt shit-blerje, dhënia-marrja me qira, investimin dhe/ose zhvillimin e pasurive ë paluajtshme në Republikën e Shqipërisë individuale, personave fizike dhe personave juridikë shqiptaëapo ëhuaj.
- Hapjen e agjencië imobiliare edhe përmes platformave elektronike online me qëllim promovimin dhe marketimin e pasurive ë paluajtshme si dhe ndërmjeësimin lidhur me shitblerjen apo dhënien me qira ëtyre.
- Këshillim për realizimin dhe zhvillimin e rezidencave ë banimit apo projekte ëtjera nëfushën e ndërtimit.
- Menaxhim, dhënie me qira, mirëmbajtje dheqdo aktivitet tjetër qëka ë bëpme menaxhimin e pasurive ë luajtshme dhe paluajtshme për vete dhe për ëtreë.
- Për realizimin e objektit ë veprimtarisë, shoqëria mundet ë lidhë kontrata me klientët qofë individ, person fizik, juridik, shqiptaë apo ë huaj; Të krijojë shoqëri bija, degë, filiale apo agjenci në ë gjithë territorin dhe/ose jashë territorit ë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi ë zbatueshëm kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe ë kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi me qellim arritjen e qëllimit ësipërcituar.
- Kryerjen e qdo aktiviteti tjetër ë nevojshëm në funksion ë veprimtarisëësaj tregtare sipas objektit dhe legjislacionit nëfuqi.

NENI 5 KOHËZGATJA

5.1 Kohëzgatja e aktivitetit të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR


- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, përpara regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë.
- 6.3 Pjesët e kapitalit zotërohen nga Ortaku i Vetëm si më poshtë:
- Z. Arsel Lampe** zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 100.000 (njëqind mijë) Lekë, e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë.

NENI 7 TRANSFERIMI I PJESEVE TË KAPITALIT THEMELTAR

- 7.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara në Statutin e *Shoqërisë* dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

NENI 8 ADMINISTRIMI

- 8.1 Emërohet si Administrator i *Shoqërisë* **Z. Arsel Lampe**, i biri i Alfred dhe Elsa, shtetas shqiptar, lindur më 23.02.1999, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. 033304581 e Nr. Personal J90223062N, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, dhe dispozitave të Statutit të Shoqërisë.
- 8.3 Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të *Shoqërisë* në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të



Biznesit si dhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

- 8.4 Administratori do të qëndrojë në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe gëzon të drejtën e riemërimit në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të tij.

NENI 9 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1 Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e *Shoqërisë* si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 9.2 Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha të njejtën fuqi ligjore.

ORTAKU I SHOQËRISË

“AS SPORTS MANAGEMENT AGENCY” SHPK

ARSEL LAMÇE

Arsel Lamçe

